

URDHËR
Nr.2004, datë 15.3.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, germa “b” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Partizan Laze Hyseni, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, i datëlindjes 31.12.1945.
 2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlin Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
 - b) Zj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - c) Znj. Mirela Llaperi, arkiv-protokoll në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
 - e) Një përfaqësues i dhomës Kombëtare të Noterisë.
 3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
 4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z.Partizan Hyseni nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.
 5. Urdhri t’i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.
 6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani